



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 523/5 Prot.

Tiranë, më 08.11.2016

V E N D I M
Nr. 118, datë 08.11.2016

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 523/1 prot, datë 02.09.2016”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Bashkisë Vlorë, për rastin e pretendimeve të ngritura nga ankesja *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 523/1 prot, datë 02.09.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur hetimi administrativ në lidhje me informacionin e përcjellë nëpërmjet kërkesës, së paraqitur nga shtetasja *****, pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit, për vendin e lirë “Specialist Jurist”, në Bashkinë Vlorë, pasi është pretenduar se janë kryer shkelje në mënyrën e zbatimit të rregullave të pranimit në shërbimin civil.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 523/2, datë 10.06.2016, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit”, është vënë në dijeni Bashkia Vlorë për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e këtij hetimi administrativ.

Nga ana e institucionit të Bashkisë Vlorë, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr. 7177/1, datë 07.09.2016, drejtuar Komisionerit, është dërguar i gjithë dokumentacioni i kërkuar për këtë rast, i cili është pjesë e dosjes së materialeve të mbledhura gjatë hetimit administrativ.

Nga tërësia e materialeve të administruara rezulton se, në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Bashkia Vlorë, nëpërmjet shkresës nr. 4999, dt. 16.06.2016, ka dërguar në Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, njoftimin për shpalljen e vendit të lirë të

punës, “*Specialist Jurist në Drejtorinë Juridike*”, nivel ekzekutiv, së bashku me kërkesat e përgjithshme e të posaçme që duhet të plotësojnë kandidatët, llojin e diplomës “*Shkenca Juridike*”, dhe nivelin minimal të diplomës “*Master Profesional*”.

Rezulton se pozicioni i mësipërm, i është ofruar fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori, për konkurrim nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe në përfundim të afatit të përcaktuar (data 29.06.2016), duke qenë se nuk u paraqit asnjë aplikant për këtë procedurë, është kaluar në procedurën e pranimit në shërbimin civil, nëpërmjet konkurrimit të hapur.

Konstatohet se njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, pasi ka realizuar verifikimin paraprak të kandidatëve të cilët plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuar në shpalljen për konkurrim, me shkresën nr. 5812, datë 12.07.2016, ka dërguar rishtaz pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, listën me aplikantët e kualifikuar për të vazhduar në fazën e konkurrimit të hapur dhe datën e testimit.

Në këtë publikim konstatohet se, janë kualifikuar për këtë rast vetëm aplikantët ***** dhe *****.

Procedura e konkurrimit është zhvilluar në datën 29 korrik 2016, në ambientet e Bashkisë Vlorë dhe është drejtuar nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit (*i ngritur me aktin nr. 80 prot., datë 23.03.2016*). Pas zhvillimit të procesit të konkurrimit, ky komision, me raportin e datës 29.07.2016, “*Struktura e ndarjes së pikëve dhe vlerësimi i kandidatëve konkurrues për pozicionin “Specialist Jurist”, në Drejtorinë Juridike, Bashkia Vlorë*”, ka shpallur rezultatin dhe pikët për secilin konkurrent, si për testimin me shkrim, ashtu dhe për intervistën me gojë. Sipas këtij akti rezulton se, konkurrentja ***** ishte vlerësuar me 71 pikë, ndërsa, konkurrentja tjetër, ***** , ishte vlerësuar me 58 pikë, në total.

Ndaj rezultatit të shpallur prej Komitetit të Përhershëm të Pranimit, bazuar në të drejtën që i njeh pika 22, e Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, të Këshillit të Ministrave, brenda afatit, në datën 01.08.2016, kandidatja ***** , ka paraqitur ankesë, duke pretenduar se rezultati i testimit nuk pasqyronte realitetin, duke kërkuar në këtë mënyrë rivlerësim të tezave.

Mbi këtë bazë, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në datën 05.08.2016, ka shqyrtuar këtë ankesë, e pasi e ka konsideruar të drejtë atë, ka kryer procesin e rivlerësimit, duke sqaruar me hollësi shkakun e dy vlerësimeve të ndryshme për të njëjtin kandidat, i pasqyruar ky proces në dokumentacionin përkatës. Pas rivlerësimit, totali i pikëve me shkrim ka ndryshuar nga 49, në 51 pikë, duke bërë që rezultati përfundimtar i vlerësimit, të ndryshonte nga 71, në 73 pikë.

Ky rezultat, me aktin nr. 6667, datë 09.08.2016, është dërguar përsëri për publikim, në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Në këto rrethana, nisur nga përshkrimi i mësipërm, arrihet në përfundimin se, procesi i konkurrimit për pozicionin në fjalë, është kryer në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Pretendimi i ankueses ***** , në lidhje me mospërfshirjen e saj në renditjen e listës përfundimtare të kandidatëve fitues, është i drejtë. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, kishte detyrimin që në përfundim të procesit të konkurrimit, në listën e fituesve duhej të kishte përfshirë dhe renditur sipas pikëve të marra, në mënyrë kumulative, jo vetëm kandidatët fitues të

konkurrimit të fundit, por edhe fituesit e konkurrimit të mëparshëm të paemëruar ende, ashtu siç përcakton pika 3, e nenit 23, të ligjit nr. 153/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo, do të krijonte mundësinë që, nëse këta të fundit do të kishin një nivel pikësh më të lartë se fituesit e konkurrimit të fundit, do t’u takonte atyre e drejta e përzgjedhjes për vendin e punës.

Në kushtet konkrete, kur konkurrentja fituese, kishte më tepër pikë se kandidatët e konkurrimit të mëparshëm (*ku përfshihet dhe ankuesja*), me të drejtë njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, ja ka ofruar asaj pozicionin e punës.

Mospërfshirja e ankueses në listën përfundimtare të fituesve të konkurrimit, në rastin në fjalë është një veprim i parregullt, por që nuk cenon në thelb përmbajtjen e procesit të konkurrimit, prandaj kjo evidentohet që të mbahet parasysh të mos përsëritet në të ardhmen.

Nga ana tjetër, vetë institucioni i Bashkisë Vlorë, me përgjigjen e dhënë nëpërmjet shkresës nr.1811, datë 11.08.2016, ka konfirmuar qëndrimin e ankueses në listën e kandidatëve fitues, të paemëruar ende.

Në këto rrethana, arrihet në konkluzionin se, veprimet administrative të kryera nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Vlorë, në kryerjen e procedurës së konkurrimit për pozicionin, “*Specialist Jurist në Drejtorinë Juridike*”, vlerësohen të mbështetura në ligj, prandaj në bazë të nenit 34, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vend për përfundimin e procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin nr. 523/1 prot, datë 02.09.2016, për verifikimin e informacionit të ardhur nëpërmjet kërkesës së shtetasës *****, në lidhje me procedurën e konkurrimit për pozicionin e punës “*Specialist Jurist*”, në Bashkinë Vlorë.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Vlorë si dhe kërkuësja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA